

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

MBI

AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE

TE

SHOQERISE

**“BYLIS” SH.A
FIER**

Për vitin financiar 2025

STUDIO AUDITIMI “ACA MARGJEKA”

(Audit, Consulting & Accounting Studio)

Tiranë me 26.03.2026

Adresa: Rr. Tre Vellezerit Kondi, Vllat Amerikane, ndertesë 736, Tirane ; Cel: +355 69 20 70 654,
www.acamargjeka.com, www.acamargjeka.com, Email: shkelzenmargjeka@yahoo.com





R A P O R T I
I
AUDITUESIT TË PAVARUR

Për : ASAMBLENË E ORTAKËVE TË SHOQËRISË “BYLIS” SH.A.

T IRANË

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Tregtare “BYLIS” SH.A., të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2025, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqitur më poshtë, paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2025, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.



Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm mbi paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, zgjedhjen dhe zbatimin e metodave të përshtatshme kontabël, dhe kryerjen e cmuarjeve kontabël të asyeshme për rrethanat. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Një përshkrim më i detajuar i përgjegjësive të audituesit për auditimin e pasqyrave financiare mund të gjendet në faqen e internetit të Institutit të Eksperteve Kontabël të Autorizuar në web: www.ieka.al. Ky përshkrim përbën pjesë të raportit tonë të auditimit.

STUDIO AUDITIMI "ACA MARGJEKA" (Audit, Consulting & Accounting Studio)

Shkelzen MARGJEKA Auditues Ligjor



TIRANË, ME 26.03.2026